



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 630/prot.

Tiranë, më 02.09.2026

NJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E AUDICIONIT PËR POZICIONET E LIRA TË PUNËS “KORIST I KATEGORISË SË PARË (ALTO)” DHE “KORIST I KATEGORISË SË DYTË (ALTO)” PRANË DREJTORISË SË OPERËS DHE FILARMONISË

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, si dhe në çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi për aq sa është e zbatueshme, **shpall audicionin për pozicionet e lira të punës “Korist i Kategorisë së Parë (alto)” dhe “Korist i Kategorisë së Dytë (alto)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë dhe përgjegjësitë/detyrat kryesore të “Koristit të Kategorisë së Parë (alto)” dhe “Koristit të Kategorisë së Dytë (alto)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë janë:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në programin e ciklit të dytë të studimeve ("Master") në "Kanto" ose të jetë në përfundim të këtij programi.
2. Të jetë i aftë për të punuar në një mjedis dinamik pune, të marrë përsipër të respektojë orarin dhe planin e punës që do të vihet nga TKOBAP-ja dhe të ketë aftësi të organizojë punën në ngarkim me efikasitet, efektivitet, efikasitet dhe sipas afateve të përcaktuara.
3. Të marrë pjesë, kur kjo i kërkohet nga institucioni në kuadër të projektit "Edukimi përmes kulturës", në procesin e edukimit që zhvillohet në shkolla, auditore etj., sipas një plani të përgatitur nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe TKOBAP-ja.
4. Të marrë pjesë në të gjitha provat në studio dhe në skenë dhe të angazhohet seriozisht në përgatitjen e shfaqjeve (premiera apo repertor të TKOBAP-së) brenda e jashtë skenave të tij. Nëse nuk është pjesë e një produksioni të caktuar, duhet të jetë në dispozicion të shfaqjeve të ardhshme me vepra të përgatitura gjatë provave.
5. Të respektojë disiplinën artistike dhe skenike në cilësinë e kërkuar.
6. Të marrë përsipër të kryejë edhe role solistike në bazë të programacionit të sezonit artistik dhe specifikave të vokalit të tij sipas rezultateve të audicioneve që zhvillohen për role apo pjesë solistike.
7. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionet e shpallura të punës.
2. Jetëshkrim (CV).
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit.
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Nëse aktualisht jeni në përfundim të programit të ciklit të dytë të studimeve ("Master") në "Kanto", të depozitohet diploma "Bachelor" me dokumentacionin shoqërues dhe një vërtetim nga IAL se jeni në përfundim të programit të ciklit të dytë të studimeve ("Master") në "Kanto". Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo dokumente të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit.
6. Libreza e punës e noterizuar dhe vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH-ja.
7. Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmia e penalitetit).
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vërtetim i aftë për punë).

Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë vetëm një letër shprehje interesi për pozicionet e lira të punës.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit deri në orën 16:30 ose i skanuar në adresën e postës elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në orën

00:00 të datës 14.10.2026 me objekt: “Aplikim për audicionin për pozicionet e punës “Korist i Kategorisë së Parë (alto)/Korist i Kategorisë së Dytë (alto)”.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Programi për konkurimin është:

1. Tre arie të përzgjedhura nga vetë kandidati (të epokave dhe stileve të ndryshme).
Ariet duhet të jenë të repertorit operistik, përkatësisht nga kompozitorë si: V. Bellini, A. Boito, G. Bizet, W. A. Mozart, G. Verdi, G. Puccini, G. Rossini, P. Mascagni, L. Cavallo, C. W. Gluck, C. Gounod, R. Wagner, C. Ma. Weber, U. Giordano, J. Massenet etj.
Ariet duhet të jenë të plota me recitative e kabaletë.
2. Shtrirja vokale (vokalizë).
3. Lexim me shikim të parë (A prima vista).
4. Pjesë korale të detyrueshme:
 - G. Rossini - “Stabat Mater” nr. 10 “Amen”
 - G. Verdi - “Messa da Requiem” - Fugato “Libera me Domine”
 - G. Verdi - “La Traviata” –Akti i I-rë komplet
Akti i II-të Tab. e I-rë “Coro di zingarelle e mattadori”
 - G. Puccini - “Madama Butterfly” – Akti i I-rë (parti koral)

Audicioni do të zhvillohet në datën 21.10.2026, ora 13:00, në Sallën Blu të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Shënime:

1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.
2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit, por vetëm pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të dokumentacionit.
3. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet postë elektronike zyrtare për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aulon Naci

